Nr. 05 prot
Dt. 14/01/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**VENDIM**

Nr. 4, datë 12/01/2022

**"PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI NË LEJEN ME NR.SERIE 000129, MIRATUAR ME VENDIM NR. 16, DATË 24.12.2020 "PËR MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJIE SHOQËRISË HEC VILIQ 1&2 SH.P.K", TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

Bazuar në pikën 2, neni 50, të ligjit 111/2012 *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, të ndryshuar, vendimit nr. 550, datë 15.07.2020 të Këshillit të Ministrave *"Për Miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimeve ujore, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre"*, si dhe në nenin 112, të *Kodit të Procedurave Administrative,* me propozim të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin - Bunë

**V E N D O S I:**

1. Korrigjimin e periudhës së vlefshmërisë në lejen "Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor" me nr. serial 000129 dhe miratuar me vendimin nr. 16, datë 24.12.2020, të Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bunë, nga *"24.12.2020 - 23.12.2025"* bëhet *"Në përputhje me afatet e koncesionit"*

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**